



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

---

Numri i lëndës: 2022:147519

Datë: 11.10.2022

Numri i dokumentit: 03515558

Ct.nr.2022:147520

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Burhan Berisha, në çështjen jokontestimore të propozuesve M. S., nga Komuna Hani i Elezit, N. A., H. A., që të dyja nga Komuna Kaçanik, Xh. S. nga Komuna e Vitisë, T. D. nga Maqedonia e Veriut dhe A. B. nga Komuna e Drenasit, duke vepruar sipas parashtrësës për tërheqje të propozimit, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 11.10.2022 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET se është TËRHEQUR propozimi me numër Ct.nr.2022:147520, i propozuesve M. S., nga Komuna Hani i Elezit, N. A., H. A., që të dyja nga Komuna Kaçanik, Xh. S. nga Komuna e Vitisë, T. D. nga Maqedonia e Veriut dhe A. B. nga Komuna e Drenasit, lidhur me kërkesën për shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit I.S..

Shpenzimet e procedurës i ka paguar pala propozuese.

**A r s y e t i m**

Propozuesit kanë paraqitur propozim me dt.20.07.2022, me të cilën kanë kërkuar shqyrtimin e trashëgimisë së tani të ndjerit I. (R...) S., nga Komuna Hani i Elezit, si pasuri e gjetur më vonë, i cili pas vdekjes ka lënë pasurinë e luajtshme dhe atë mjetet monetare, sipas Vendimit me nr. kërkesë ... të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, me të cilin vendim i është njohur e drejta në dëmshpërblimin shëndetësor.

Propozuesi M. S., më datën 03.10.2022, pranë kësaj gjykatës ka paraqitur kërkesë për tërheqjen e propozimit, ku duke u bazuar

Meqë gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas propozimit, për shkak se propozuesi M. S., brenda afatit të caktuar ka paraqitur parashtresë për tërheqjen e propozimit, andaj në pajtim me nenin 124, paragrafi 2, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEGA KAÇANIK**

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2022:147520, dt.11.10.2022

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

**KESHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit.